

PROCESVERBAL
nga seanca e 26-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 12.06.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Emilija Janevska, dr. Ivana Stojanovska, Maja Damevska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 26-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota “pro”, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 25-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 31.05.2024.
2. Propozim për miratimin e Udhëzimit për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve.
3. Propozim për miratimin e Rregullores për akses në shërbimet mediatike.
4. Draft-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transmetimin e veprave audiovizuele evropiane dhe veprave nga producentë të pavarur.
5. Propozim për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër operatorit TOTAL TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 të LSHMAAV.

6. Propozim-vendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup.
7. Propozim për dhënie miratimi për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Byro për përkthim.
8. Propozim për dhënie miratimi për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e sistemit të menaxhimit automatik me dokumente.
9. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 6 vota “pro” miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 25-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 31.05.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski tha se do të bëjë një hyrje të përgjithshme për të tri Rregulloret e propozuara, ndërsa shpjegim më të detajuar do të japin udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Janevska dhe udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva. Ai ka shpjeguar se me ndryshimet në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nga 31 dhjetori 2018, në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare thuhet se të gjitha aktet e reja nënligjore do të sillen nga përbërja e re e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Gjithashtu, është kërkuar mendim plotësues nga ministri i atëhershëm Damjan Mançevski, i cili ka shpjeguar se aktet nënligjore ekzistuese mund të ndryshohen në pajtim me ndryshimet e atëhershme të Ligjit. Por me ndryshimet e parafundit në korrik 2023, për harmonizim me direktivën evropiane, duhen bërë disa rregullore të reja dhe disa të ndryshohen. Por, për dallim nga dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të vitit 2018, në ndryshimet e vitit të kaluar nga muaji korrik, është përcaktuar saktësisht afati në të cilin kjo përbërje e Këshillit të Agjencisë duhet t'i miratojë, gjë që është kontradiktore me ndryshimet fillestare. Meqenëse këto janë dispozita kalimtare dhe përfundimtare, që atëherë ka pasur më shumë ndryshime dhe në këtë ndryshim të parafundit është saktësisht i cekur afati në të cilin Këshilli duhet t'i miratojë aktet nënligjore, të cilat po përgatiten në bashkëpunim me projektin tvinging të financuar nga Komisioni Evropian, dhe referohet për shërbimin publik dhe për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Z. Petrushevski tha se drejtori bëri një hyrje të përgjithshme për Pikat 2, 3 dhe 4, dhe kërkoi nga udhëheqëset Emilija Janevska dhe Magdalena Davidovska Dovleva që t'i shpjegojnë pikat një nga një sepse janë të rëndësishme dhe se kërkon kohë për çdo informacion që ata do të thotë për tu procesuar.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Janevska, shpjegoi se me ndryshimet e LSHMAAV nga viti 2023, ka nevojë të ndryshohet dhe Udhëzimi për zbatimin e dispozitave për plasimin e produkteve. Me ndryshimet ligjore janë bënë ndryshime thelbësore në zbatimin e këtij lloji komunikimi komercial. Gjegjesisht, më parë përdorimi i plasimit të

produktit si komunikim komercial ishte përgjithësisht i ndaluar në programet e transmetuesve, përjashtim bënin disa programe, ndërsa tani me ndryshimet e reja, kjo praktikë përgjithësisht lejohet në të gjitha llojet e programeve, tani përjashtohen vetëm pesë lloje programesh. Ndryshe, mënyra e zbatimit të dispozitave, principet që duhet të respektohen janë të njëjta, e reja është se dispozita, përveç se tani për televizionet, rekomandohet edhe për radiot dhe për platforma për ndarjen e videove dhe për ofruesit e shërbimeve video sipas kërkesës, dhe për këto arsye, janë bërë disa rregullime në këtë Udhëzues. Draft-tekstin e Udhëzimit Këshilli e miratoi në seancën e 9-të mbajtur më 12 mars 2024, dhe u hap seancë publike në kohë zgjatje prej 90 ditësh. Seanca e hapur përfundoi më 11 qershor, gjatë seancës së hapur nuk është marrë asnjë koment apo vërejtje për Draft-tekstin e Udhëzimit. Për këto arsye, propozohet miratimi i Udhëzimit me tekstin e propozuar, dhe detyrohet që Shërbim profesional të përgatisë Tekst të pastruar dhe më pas t'u dorëzohet transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve video sipas kërkesës dhe të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë.

Z. Fidanoski tha se diskutimi i tij do të vijojë me atë që tha drejtori Trajçevski. Pajtohet që si Këshill duhet t'i miratojnë këto akte nënligjore. Mjedisi mediatik, dinamika se si ndryshon me kalimin e kohës, kompetencat që i ka Këshilli i Agjencisë, precizimi (sqarimi) i disa gjërave mund të kërkojë edhe ndryshime më të detajuara ligjore dhe absolutisht beson se është e nevojshme të jemi në hap me kohën, sepse nuk dihet se kur do të zgjidhet përbërja e re e Këshillit dhe nuk do të presin ta lënë kështu. Sa i përket kësaj pike, ai kujton se ka marrë pjesë me disa të tjerë nga Agjencia, përfshirë këtu dhe drejtorin Trajçevski, në një debat në Shtëpinë Evropiane, kur u paralajmërua se debati do të zgjasë 90 ditë, se atëherë kishte disa diskutime interesante, por i vjen keq që ato diskutime nuk u kthyen në propozime, sugjerime me shkrim, pra gjithçka mbeti vetëm në diskutime të disa prej të pranishmëve.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasimin e produkteve, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë tekst të pastruar të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve, ndërsa Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit t'ua dorëzojë transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve video sipas kërkesës dhe ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Janevska shpjegoi se me ndryshimet e Ligjit nga vitit 2023, është bërë ndryshim edhe në nenin 26, i cili i referohet detyrimeve për arsimimin mediatik dhe ofrimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar. Është bërë ndryshim thelbësor në dispozitën ligjore, pra nga rekomandimi që mediat t'i bëjnë programet e aksesueshme, tashmë ata kanë detyrim ligjor për t'i bërë programet të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar, nga këtu dhe nevoja për miratimin e një akti të ri. Pra, kjo është Rregullore e re për të elaboruar dispozitat e nenit 26. Kujtoi se Rregullorja është punuar në kuadër të projektit "Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave në Maqedoninë e Veriut (PRO-FREKS)" e cila financohet nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me konsulentin që ishte e angazhuar znj. Deirdre Kevin. Ky Draft-akt është miratuar në seancën e 9-të të Këshillit, mbajtur më 12 mars 2024 dhe për të është

mbajtur seancë e hapur prej 90 ditësh, e cila ka zgjatur deri më 10 qershor, ku nuk është marrë asnjë koment apo propozim. Prej aty, ajo propozoi që Këshilli të miratojë Rregulloren e propozuar për aksesueshmëri (qasje) në shërbimet mediatike, e cila më pas do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë dhe do t'u dërgohet transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve video sipas kërkesës.

Z. Fidanoski lidhur me këtë Rregullore tha, derisa ishte rekomandim për transmetuesit të ofrojnë programe për qasje, kjo me shumë vështirësi realizohej, kjo nuk është kritikë për mediat, megjithatë periudha e fundit zgjedhore tregoi se kur është fjala për detyrim, edhe pse ndoshta nuk është e thjeshtë për ta, mund të realizohet. Shpreson sinqerisht që kjo të zbatohet me sukses dhe ky 2% do të jetë akoma më shumë si një shifër ekzakte në përmbushjen e asaj përqindje të programit të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Janevska, shpjegoi se 2% është detyrim për katalogët për shërbime video sipas kërkesës, përndryshe për transmetuesit, gjegjësisht detyrimi është vetëm për televizionet në nivel kombëtar të ofrojnë nga një program në vit dhe vazhdimisht dhe në mënyrë progresive çdo vit të rrisin vëllimi për një program. Me këtë Rregullore nuk detyrohen transmetuesit në nivel rajonal dhe lokal, sepse ata mendojnë se kjo do të ishte një detyrim i tepërt për kapacitetet e tyre, kështu që atyre u lihet mundësia të transmetojnë programe që do të ofrohen nga transmetuesit në nivel kombëtar nëse janë të interesuar dhe të përdorin mënyra të tjera për të siguruar dukshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në programin e tyre në përgjithësi.

Z. Fidanoski falënderoi për korigjimin dhe theksoi se mbikëqyrja e bërë nga ai ishte e paqëllimshme.

Z. Petrushevski pyeti se mos respektimi i kësaj Rregulloreje parashikon ndonjë gjobë dhe a janë marrë vërejtje për Rregulloren?

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Janevska, tha se me këtë Rregullore do të vepohet njëllor si dhe për dispozitat e tjera, paralajmërim, më pas procedurë për kundërvajtje në pajtim me Ligjin. Sa i përket vërejtjeve ajo tha se Rregullorja është mjaft liberale, se janë shumë të vogla detyrimet për transmetuesit në Rregullore dhe ndoshta për ato arsye nuk ka pasur vërejtje. Siç tha edhe këshilltari Fidanoski, fushata zgjedhore tregoi se mund t'i përmbushin detyrimet e tyre, gjatë kohës së zgjedhjeve siguruan qasje për personat me aftësi të kufizuara në dy programe, në baza ditore siguruan qasje në një edicion lajmesh, dhe në nivel kombëtar siguruan qasje të një programi informues. Ai beson se nuk do të jetë problem nga një program në nivel vjetor të bëhet i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara.

Z. Trajçev tha se kjo Rregullore është një hap i madh në drejtim të ndihmës së personave me aftësi të kufizuara, sepse sot, në kohën e sotme ku informacioni është bazë për çdo zhvillim, informim dhe veprim në shoqëri, të gjithëve u mundësohet informimi. Ai beson se në këtë mënyrë bëhet një hap përpara dhe shtypje më tej që transmetuesit në një periudhë të ardhshme të gjithë programet t'ua përshtatin këtyre personave, të cilët fatkeqësisht janë në një pozitë më pak të favorshme se të gjithë njerëzit e tjerë dhe duhet tu mundësohet akses në informacion që të gjithë ne kemi, sidomos në kohën e sotme ku pa informacion dhe aksesueshmëri në informacion është e vështirë të funksionosh.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për qasje në shërbimet mediatike, me tekstin e propozuar.

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Rregulloren e miratuar për qasje në shërbimet mediatike ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë dhe t'ua dorëzojnë transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve video sipas kërkesës.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi se nevoja për ndryshimin e Rregullores për transmetimin e veprave audiovizuele evropiane dhe veprave nga producent të pavarur buron nga neni 60 i Ligjit, i cili përcakton detyrimin ndaj Agjencia që të parashikon mënyrën e sigurimit të pjesëmarrjes dhe shikueshmërisë së veprave evropiane në katalogun programor të ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizuele sipas kërkesës. Ajo tha se ndryshimet janë bërë në bashkëpunim me ekspertë nga projekti "Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave në Maqedoninë e Veriut (PRO-FREKS)", me ekspertë gjermanë dhe kroatë. Bëhet fjalë për Draft verzion, me hapjen e seancës publike që do të zgjasë 75 ditë. Pritet që në 75 ditët e ardhshme të merren mendime dhe vërejtje, para së gjithash sepse sektori me ofruesit ekzistues ka bashkëpunim dhe komunikim shumë të mirë dhe pritet nga ata realisht të përfshihen në diskutim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Draft-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transmetimin e veprave audiovizuele evropiane dhe veprave nga producentë të pavarur, me tekstin e propozuar.

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për transmetimin e veprave audiovizuele evropiane dhe veprave nga producent të pavarur, ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë për të siguruar diskutim publik gjatë 75 ditë, pra t'u mundësohet të gjithë palëve të interesuarve të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Draft-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transmetimin e veprave dhe veprave audiovizuele evropiane dhe veprave nga producent të pavarur, t'ua dorëzon ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizuele.

Pika 5

Z. Trajčevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit TOTAL TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 të LSHMAAV. Ai shpjegoi se tek ky operator i rrjetit të komunikimit publik me mbikëqyrje kontrolli është konstatuar se nuk kryen ritransmetim të shërbimeve programore "TVM 2", "TVMT 4" dhe "TVM 5", gjë që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) të LSHMAAV. Meqenëse kjo është shkelja e dytë e konstatuar në këtë vit kalendarik, sugjerohet që të fillojë procedura para gjykatës kompetente për shqiptimin e gjobës përkatëse.

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor nr.11-2637/1 datë 04.06.2024 të Shoqërisë për Tregti dhe Shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, dhe ka konstatuar shkelje të nenit 143 paragrafi (3) të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri ka konstatuar kundër Shoqërisë për Tregti dhe Shërbime TOTAL TV SHPK Shkup që të fillojë procedurë kundërvajtëse para gjykatës kompetente për shkak se

nga mbikëqyrja është konstatuar se operatori në fjalë i rrjetit publik të komunikimit elektronik i cili sipas notifikimit (njoftimit) nga Agjencia për komunikime elektronike, mund të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pakon e saj programore, nuk ka ofruar shërbime programore të shërbimit publik radiodifuziv, përkatësisht nuk kryen ritransmetim të shërbimeve programore "TVM 2", "TVM 4" dhe "TVM 5", që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për operatorin e caktuar.

Pika 6

Z. Trajçevski shpjegoi se transmetuesi Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup ka dorëzuar deklaratë për ndërprerjen vullnetare të programit dhe kthimin e lejes për transmetim televiziv. Në komunikim me të, duke qenë se tani është koha që ai të paguajë kompensimin vjetor, ai tha se është i gatshëm t'i paguajë të gjitha shpenzimet deri në ditën e mbajtjes së seancës, gjegjësisht derisa Këshilli të miratojë Vendimin për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup. Ai tha se kjo pikë ka të bëjë me pikën nga seanca e kaluar publike dhe është formale, pasi që transmetuesi vetë ka dhënë dorëheqje nga leja.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Akvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqatës Tregtare Radiodifuzive Televizioni 3 SHPKNJP Shkup .

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Byro për përkthim. Ajo ka shpjeguar se për realizimin e këtij furnizimi janë përmbushur obligimet ligjore, është e paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2024 dhe mjetet janë të parashikuara me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2024 dhe do të parashikohen në përputhje me Plani financiar për vitin 2025, sepse marrëveshja që do të rezultojë nga zbatimi i këtij furnizimi do të lidhet për një periudhë dyvjeçare. Sipas shumës së mjeteve të parashikuara, ky furnizim do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët në përputhje me të gjitha dispozitat e Ligjit për furnizim publik për këtë lloj procedure, që do të thotë se do të publikohet edhe në sistemin elektronik të furnizimit publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Byro për përkthim.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Byro për përkthim, është paraparë dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, pra do të parashikohen dhe në planin financiar për vitin 2025.

Pika 8

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozimin për dhënie e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim-publik shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e sistemit për menaxhim automatik me dokumente. Ajo ka shpjeguar se për realizimin e këtij furnizimi janë përmbushur detyrimet ligjore, është e paraparë në Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024, ndërsa mjetet janë të parashikuara nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2024 dhe përkatësisht do të sigurohen në Planin Financiar për vitin 2025, sepse marrëveshja që do të rrjedhë nga realizimi i këtij furnizimi do të lidhet për një periudhë dyvjeçare. Sipas shumës së mjeteve të parashikuara, ky furnizim do të realizohet si procedurë e hapur e thjeshtuar, me publikim në sistemit elektronik për furnizim publik dhe Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Z. Petrushevski tha se si kryetar i Këshillit ka mundësi t'i shfrytëzojë shërbimet e këtij sistemi, i cili tha se është cilësor, i lehtë për t'u përdorur dhe mbi të gjitha redukton përdorimin e letrës në Agjenci.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e sistemit të menaxhimit automatik me dokumente.

Zbatimi i procedurës së furnizimi publik për lëndën-shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e sistemit të menaxhimit automatik me dokumente, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, gjegjësisht do të parashikohen më tej dhe në Planin Financiar për vitin 2025.

Pika 9

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**